10. Demtime te ndryshme mekanike, te çara te lehta, lehtesisht te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma lejohen deri ne 5 % e partise.

Me semundje me njolla myku nuk lejohen.

11. Pesha e kokrres nga 05 deri ne 1 kg

12. Perimet amballazhohen te ndara sipas kultivareve ne arka te pastra,te forta,te thata te prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik perkates ne fuqi.
Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohen:

3. Emerimi i prodhuesit

4. Lloji prodhimit.

1. Cilesia.

2. Pesha neto bruto

13. Malli te shoqerohet me certificate origjine dhe raport analize te laboratorit

14. Transporti i perimeve behet me mjete te pastra,mbrojtura nga demtimet e faktoreve te tjere atmosferike,duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportin e produkteve ushqimore

- **QEPË E THATË**

Bazuar në SSH 1468:1987 ose ekuivalentin e tij.

Lloji: Qepe e thate per treg cilesia e pare

TREGUESIT Organo-Leptike

1Pamja e jashtme: me pjekuri te plote, cipe e bisht te thate,te shendosha e te plota.

2. Ngjyra dhe forma: me ngjyren dhe formen tipike te kultivarit dhe me gjatesi te bishtit deri ne 7 cm

3. Diametri: per ovalet 4- 8 cm dhe per llojet e tjera 5-10 cm.

DEMTIME MEKANIKE NUK LEJOHEN

1. Cifla,bishta lejohen jo me shume se 1%, me demtime te lehta.

2. Lende te huaja (cifla,bishta) jo me shume se 1%.

3. Me semundje nuk lejohen.

4. Te ngrira,te kalbura e te ngrira nuk lejohen.

5. Lejohet furnizimi me qepe te thurura ne vargje me gjatesi te ndryshme.Pesha e materialit te perdorur per thurje te mos kaloje 6% te peshes se pergjithshme. **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1.Perimet amballazhohen te ndara sipas kultivareve ne arka te pastra,te forta,te thata te prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik perkates ne fuqi.

3. Transporti i perimeve behet me mjete te pastra,mbrojtura nga demtimet e faktoreve te tjere atmosferike,duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportin e produkteve ushqimore

4. Qepa e thate amballazhohet edhe ne thase.

5. Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise.

MARKETIMI

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohen:

1. Emerimi i prodhuesit
2. Lloji prodhimit.
3. Cilesia.
4. Pesha neto bruto

Malli te shoqerohet me certifikate origjine dhe raport analize te laboratorit

.

- **QUMESHT**

Bazuar ne SSH 1563/87, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

TREGUESIT CILESORE ORGANOLEPTIKE(Pamja e jashtme ngjyra,era dhe shija)

Çmimi i ofertes qe do te paraqitet nga çdo konkurent duhet te jete qumesht i fresket per konsum me 3 – 3.4 % yndyre dhe cilesite e meposhtme

Pamja e jashtme: Qumeshti eshte leng homogjen,pa lende te huaja qe duken ,notojne ose precipitojne.Gjate derdhjes ne ene duhet te jete me rrjedhje te njellojte dhe pa nderprerje. Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Ngjyra : e bardhe e njellojte me nuance te lehte ne te verdhe

Shija dhe era: e kendeshme,lehtesisht e embel,me shije te lehte zierje,pa shije dhe ere te huaj.Nuk duhet te lejohet perdorimi i lendeve konservuese neutralizuese dhe te huaja

TREGUESIT FIZIKO-KIMIKE

Dendesia: ne 20°C, jo me pak se

1.029°T Yndyra: ne kufijte 3 –

3.4 %

Aciditeti: jo me shume se 20% i shprehur ne grade Torner. Lende te thata (pa yndyre); jo me pak se 8.5%.

Prova e pasterizimit(fosfatazes dhe peroksidazes): duhet negative. Pastertia:pa mbetje me site mendafshi apo merle dyfishe

Nuk lejohen mikroorganizma patogjene.

AMBALLAZHIMI MARKETIMI DHE ETIKETIMI

1. Qumesht duhet te jete i amballazhuar me kuti tetrapak me peshe 1 liter dhe i shoqeruar me analize “Fiziko-Kimike dhe raport Analize Mikrobiologjike nga institucione ligjore.
2. Ruajtja dhe transportimi ne temperature 2-8°C
3. Meqenese do te perdoret per konsum te kategorise me rrisk te larte(Kopshte-Çerdhe) subjekti detyrimisht duhet te furnizojë qumesht mbasi te kete kaluar procesin termik.

Ne çdo paketim duhet te jete e vendosur etiketa me te gjithë elemetet:

1. Emertimi prodhuesit
2. Emri i plote i produktit
3. Pesha neto ose vellimi i produktit
4. Data e prodhimit,data e skadences,
5. Elementet e gjurmueshmerise se produktit.
6. Kushtet e veçanta te ruajtjes
7. Ngarkesa mikrobike sipas normave te percaktuara nga Ministria e Shendetesise.
7. Çdo sasi e furnizuar duhet te shoqerohet me flete-analize.

• KOS

Bazuar në SSH 1443:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi

- **Me yndyrë 2 %, cilësi e parë**
- **L**

loji:

Lope

Kerkes

at

cilesor

e:

Te plotesoje treguesit e cilsise si me poshte :

Ngjyra : E bardhe, ne siperfaqe e bardhe lehtesisht ne krem . Struktura : E ngjeshur ,pa pore, ne prerje pa shtresa dhe ndarje hirre .

Era dhe shija : E kendeshme ,karakteristike e kosit te embel ,lehtesisht e tharte.

Treduesit fiziok – kimike :

Acidi ne grade Tjorenr jo me shume se 120 Yndyra ne $\%2\pm0.1$

Ngarkesa mikrobiale sipas normave te miratuara nga Ministira e Shendetesise. Ambalazhimi, marketimi dhe etiketa:

Kosi ambalazhohet ne paketim shishe qelqi ose plastike, me gryke te gjere ,me mase 500ml – 1 Lte mbyllur me kapak .

Ambalazhet qe perdoren te jene ne gjendje te mire ,te paster ,te thate dhe pa ere te huaj .

Materiali qe perdoret per ambalazhim duhet te jete sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standartet perkatese .

Shmangiet e lejuara ndaj vellimit nominal te kosit te ambalazhuar jane :

- $\pm 20g$ per ambalazhet 1000g
- $\pm 15g$ per ambalazhet 500g

Ne cdo paketim vendoset etiketa ku shenohet :

- Emri ndermarrjes prodhuese
- Perqindja e yndyres
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Standarti ne fuqi

Etiketimi i kosit te ambalazhuar ne kuti behet me stampim .

Ruajtja dhe transporti :

Kosi ruhet e tregetohet ne frigorifer temperaturen nen 10°C dhe ne mungese te tyre mbahet ne mjedis te fresket dhe te ajrosur . Koha e ruajtjes ne frigorifer eshte 24 ore nga koha e prodhimit . Transporti behet me mjete te, mbuluara, te pastra ose me mjete frigoriferike .

Analiza mikrobiologjike

Enterobacteriaceae <10 cfu/ml

Malli duhet te shoqerohet me raport analize te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi .

Raport analiza e paraqitur duhet te permbaje te gjitha treguesit e mesiperm .

Raport analiza “fiziko-kimike “ dhe ”raport analiza Mikrobiologjike” duhet te paraqiten ne origjinale ose fotokopje te noterizuara

- **DJATHË LOPE**

Bazuar ne SSH 1410:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, “Për zëvendësimin e aneksit i, te urdhrit nr.234, dt. 20.05.2014 per miratimin e rregullores “mbi kriteret mikrobiologjike per produktet ushqimore”.

Treguesit Organo-leptike:(Pamja e jashtme,forma,era dhe shija)

Çmimi i ofertës që do të paraqitet nga çdo konkurent duhet të jetë vetëm djathë i bardhë fetë neprodukt me baze qumesht lope,i stazhionuar jo më pak se 45 ditë,i pa falsifikuar dhe pa lende shtesë (niseshte) apo lende të tjera të huaja.Nuk lejohet prodhimi i djathit me perzierje të qumeshtit me qumesht pluhur ose të kondësuar

Sasia e djathit që do të furnizojë institucionet tona duhet të jetë vetëm **cilesia e parë** me keto karakteristika:

1. Ngjyra: e bardhë
2. Pamja e jashtme e formuar mirë,e pastër dhe pa njolla. Në prerje është masë e njëllojtë e pastër,pa lende të huaja,me ngjyrë të bardhë deri në krem.
3. Forma:prizëm trekëndësh me një faqe anësore cilindrike,masa e formës: 2-3 kg
Shija dhe era: e këndeshme,specifike e djathit të butë të stazhionuar,pa shije të hidhur e djegësë dhe pa erë dhe shije të huaj.
4. Struktura dhe konsistenca: e lëmuar,e butë dhe pa dallim shtresash.
5. Në prerje është e njëllojtë,e pastër,pa lende të huaja,me ngjyrë të bardhë deri në krem.

TREGUESIT FIZIKO-KIMIKE

Djathi duhet të jetë i prodhuar me qumesht lope dhe të plotësojë treguesit si më poshtë:

✓ Lageshtira në përqindje jo më shumë se:
Për periudhën nga 1 Maj deri më 30 Shtator të
jetë 52% Për periudhën nga 1 Tetor deri më
30 Prill të jetë 56%

✓ Lenda e thatë në përqindje jo më pak se:
Për periudhën nga 1 Maj deri më 30 Shtator të
jetë 48% Për periudhën nga 1 Tetor deri më
30 Prill të jetë 44%

- ✓ Yndyra në lenden e thatë në përqindje jo më pak se 50
- ✓ Permbajtja e kripës në përqindje jo më shumë se 4 ± 1
- ✓ Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara të Ministrisë së Shëndetësisë.
- ✓ Në çdo parti djathi të furnizuar lejohen feri në 5% copa dhe 2% therrime,masa e një cope me e madhe ose e barabartë me 50 gr

Te gjithë treguesit cilësorë të përshkruar më sipër janë për cilësinë e parë të djathit të bardhë i prodhuar me qumesht lope.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi: Brenda kushteve higjeno-sanitare, me peshe sipas kerkesave te Entit
2. Djathi ne voze qendron i mbuluar me shellire e cila permban 10-14% kripe deti.
3. Etiketa e produktit te ambalazhuar duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga amballazhi, ku te shenohen:
 1. Emertimi prodhuesit
 2. Emri i plote i produktit
 3. Pesha neto ose vellimi i produktit
 4. Data e prodhimit, data e skadences,
 5. Elementet e gjurmueshmerise se produktit.
 6. Kushtet e vecanta te ruajtjes
 7. Rekomandime per menyren e perdorimit, nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise, ose mbi vlerat e produktit ushqimor. Keto te dhena te jepen mbi amballazh ose mbi etikete.
8. Shenimet e detyrueshme te marketimit duhet te jene te qarta, te dukshme mire, te pelqyeshme dhe lehtesisht te lexueshme ne kushte normale te blerjes dhe perdorimit.
9. N.q.s eshte i mbuluar me nje material veshes te gjitha informacionet e detyrueshme duhet te figurojne mbi kete te fundit, ose etiketa e amballazhit duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
10. Emri i produktit ushqimor dhe permbajtja neto duhet te bjere ne sy ne pamje te pare Gjuha e perdorur ne etiketen origjinale apo atiketen shtese duhet te jete ne shqip dhe te permbaje te gjitha informacionin e detyrueshem.
11. Çdo parti malli e furnizuar duhet te shoqerohet me çertifikate origjine dhe raport-analize laboratorike.
12. Ruajtje dhe transportimi: Djatherat e bute ruhen ne frigorifer ne temperature nga 3-5 ° C dhe lageshtiren e ajrit 95%. Koha e ruajtjes ne keto kushte eshte deri ne 12 muaj. Transportimi i djatherave te bute nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike. Ndersa brenda rrethit transportimi mund te behet dhe me mjete te zakonshme te mbuluara dhe te pastra te cilat jane te destinuara per transportimin e produkteve ushqimore.

- **GJALPË I FRESKËT LOPE**

Bazuar në SSH 1445:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

TREGUESIT CILESORE ORGANO-LEPTIKE

1. Lloji : Gjalp i fresket dhe me kripe,cilesia e pare.
2. Pamja e jashtme: e njetrateshme,pa shtresa ne prerje,me siperfaqe te shndriteshme,pa pika uji dhe mbeturina dhalli
3. Ngjyra:Krem deri ne te verdhe te celur(karakteristike e kremes nga i cili eshte prodhuar) Ngjyra duhet te jete e njellojte ne te gjithë masen.
4. Era dhe shija:E kendeshme,karakteristike e gjalpit lehtesisht te kripur.Pa ere dhe shije te huaj.

TREGUESIT FIZIKO-KIMIKE

1. Yndyre: Per cilesine e pare jo me pak se 80%
2. Lageshtira: Per cilesine e pare jo me shume se 17%.
3. Lenda e thate.....Pa yndyre jo me shume se 2%
4. Kripe : Jo me shume se 2%
5. Aciditeti: I shprehur ne grade Ketshtofer,jo me shume se 5%
6. Konsistenca: Ne temperaturen 10-12° C duhet te jete gjysem e forte.
7. Ngarkesa mikrobike:Brenda normave te lejuara nga Ministria e Shendetesise.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi:Gjalpe i fresket i kripur amballazhohet ne kuti kartoni te valezuar me mase0.5- 5 kg(sipas kerkeses se Entit) e veshur nga brenda me leter pergamen.
2. Etiketa e produktit te amballazhuar duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga amballazhi.N.q.s eshte i mbuluar me nje material veshes te gjitha informacionet e detyrueshme duhet te figurojne mbi kete te fundit,ose etiketa e amballazhit duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
3. Emri i produktit ushqimor dhe permbajtja neto,duhet te bjere ne sy ne pamje te pare.
4. N.q.s.gjuha ne etiketen origjinale nuk eshte e pranueshme per konsumatorin,per te cilin ajo eshte e destinuar,duhet te perdoret nje etikete tjeter shtese qe permban informacionin e detyrueshem ne gjuhen shqipe.
5. Shenimet e detyrueshme te marketimit duhet te jene te qarta,te dukshme mire,te pelqyeshme dhe lehtesisht te lexueshme ne kushtet normale te blerjes dhe perdorimit.
6. Ne rastin kur etiketa eshte zevendesuar ose plotesuar me nje tjeter,shenimet e detyrueshme duhet te jene pike per pike si ne etiketen origjinale.
7. Malli te shoqerohet me certifikate origjine dhe raport analize te laboratorit.

RUAJTJA DHE TRANSPORTIMI

1. Gjalpi ruhet ne frigorifer ne temperaturen 2- 4°C
2. Transporti i gjalpit nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike.Ndersa transporti brenda rrethit lejohet te behet me mjete te zakonshme (ne varesi te stines) te mbuluara, qe plotesojne kushtet higjeno-sanitare dhe qe jane te destinuara per transport te produkteve ushqimore.

MARKETIMI

1. Emertimi i prodhuesit.
2. Emertimi i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit.
4. Data e prodhimit.
5. Data e skadences.
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes.
7. Rekomandime për mënyrën e përdorimit, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësive, ose mbi vlerat ushqimore të produktit, të gjitha këto të dhëna të shkruara mbi amballazh ose mbi etikete.

Çdo sasi malli e furnizuar në institucionet tona duhet të shoqërohet me : **faturen**

tatimore të shitesit, fletë analize laboratorike, etiketen e prodhuesit me të gjithë elementet e sigurisë ushqimore (date prodhimi dhe skadence) dhe ato të gjurmueshme për produktin.

- **GJIZA PA KRIPE**

Bazuar në SSH 1424:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Urdhër të Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi

- **Gjizë pa kripë, e freskët, cilësi e parë**
- **Lloji: Lope**
- 1. Lloji: Gjizë e freskët dhe pa kripë, cilësi e parë.
- 2. Përbërja : E pastër me ngjyrë të bardhë, lehtësisht në grë.
- 3. Struktura : E njëllojtë në të gjithë masën, pa therrime djathi.
- 4. Era dhe shija : E këndeshme, karakteristike e gjizës së freskët, lehtësisht në të embël, pa shije thartire.

Treguesit fiziko kimike :

1. Lageshtia në % jo më shumë se 68.
2. Yndyra në % jo më pak se 3.

Analiza mikrobiologjike

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

-E-coli 100-1000 cfu/ml

Raport analiza e paraqitur duhet te permbaje te gjithë treguesit e mesiperm .

Amballazhimim :Gjiza e fresket ambalazhohet ne vasketa plastike te valezuara me mase 0,5kg (sipas kerkesese se entit)

Mbi cdo ambalazh me gjize vendoset etiketa ne te cilen shenohen :

1. Emir i prodhuesit .
2. Emri i produktit .
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit .
4. Data e prodhimit .
5. Data e skadences .
6. Kushtet e vecanta te ruajtjes .
7. Rekomandime per perdorim , nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatete e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimore,keto te dhena te jepen mbi ambalazh ose mbi etikete .Etiketa e produktit te ambalazhuar duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga ambalazhi .Shenimet e detyrshme te marketimit duhet te jene te qarta, te dukshme mire , te pashlyeshme dhe lehtesisht te lexushme ne kushte normale te blerjes dhe perdorimit .

Ruajtja dhe transporti :

1. Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4 grade C
2. Transporti i gjizes behet me mjet frigoriferik

• VEZË PULE

Bazuar në SSH 325-1 :1993 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët, në udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Lloji :Veze pule per treg madhesia L

1. Pamja jashtme:E paster dhe pa plasaritje.Lejohen ndotje te lehta.
2. Dhoma e ajrit(lartesia) mm,jo me shume se 9.
3. E bardha e vezes: E dendur e kulluar dhe pa njolla gjaku(te kontrolluara ne ovoskop)
4. E verdha e vezes.Kompakte e ndodhur ne pozicionin qendror,pak e levizshme.Lejohet devijim i vogel nga pozicioni qendror.
- 5.Era: Pa ere prishje dhe ere tjeter te huaj.
6. Masa ne gr jo me pak se 55 gr.
- 7.Marketimi dhe amballazhimi: Vezet duhet te jene te kolauduara,te fresketa,te vulosura me vulen e prodhuesit,ku shenohet data e prodhimit, kodin e kontrollit qe

duhet te perkoje me kodin e vendosur ne raport analizen qe shoqeron mallin dhe per te dalluar origjinen e mallit. Vezet te jene vendosura ne kartona fole (bikurina) me 30 veze secila dhe ne çdo kuti kartoni vendosen 12 cope kartona fole. Nuk lejohen te plasaritura, me rrjedhje.

8. Çdo parti malli e furnizuar duhet te shoqerohet me certificate origjine dhe raport-analize laboratorike.

- **MISH VICI**

Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”.

Klasifikimi:

- **I freskët,
cilësia e parë
Kërkesat cilësore**

Mishi përgatitet në gjysmë trupi dhe në çerek. Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebrave të shtyllës

kurrizore, duke lënë në një rën anë palcën e kurrizit. Ndarja e gjysmë trupave në çerek bëhet nëpërmjet brinjës 12 dh 13 dhe nëpërmjet brinjës 7 dhe 8 kur mishi i nënshtrohet ndarjes anatomike. Koka pritët nëpërmjet kockave të qafës dhe të vertebrës së parë të qafës(atlanti) këmbët te kyçet e gjurit, kurse bishti pritët nëpërmjet vertebrës së parë e të dytë të tij. Organet e brendshme, përveç veshkave, veçohen.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Tendinat janë të shëndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shëndritshme. Lëngu është i tejdukshëm.
- *Ngjyra:* Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa qe ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjemit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.
- *Era:* e këndshme , karakteristikë e llojit.
- *Palca e kockave :* Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë. Në prerje është e shëndritshme.
- *Konsistenca:* E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me

gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.

- *Lëngu i mishit pas zierjes*: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre. Treguesit fiziko-kimikë:
 - *Azot i tretshëm, mg, amoniak (NH₃)/100 gr produkt* jo më shumë se 20.
 - *Aciditeti i shprehur në pH*: 5.2 deri 6.4.
 - *Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H₂S)*: Negativ.
 - *Reaksioni Kreis*: Negativ.
 - *Ngarkesa mikrobike*: Brenda normave të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Treguesit kimikë dhe mikrobikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme, këmbë dhe kokë.

Ambalazhimi dhe markimi

Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit.

Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje.

Tregtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.

Mishi duhet të thërrë në ambiente (thertore të licencuara), të cilat plotësojnë standardet higjieno – sanitare dhe veterinare.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-riciklueshme dhe të shoqëruara me certifikatë konformiteti.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Ambalazhet duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë. **Verifikimi i kërkesave cilësore**

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti, e cila përfaqëson sasinë e mishit e të njëjtit lloj i thërrur në të njëjtën thertore dhe që dorëzohet njëherësh.

Kontrolli veterinar dhe sanitar i mishit bëhet sipas ligjit në fuqi “Mbi shërbimin veterinar”. Mishi të jetë i cilësisë së parë, i shoqëruar me certifikatë veterinare sipas ligjeve në fuqi.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.

Mishi i viçit te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me Certifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Ruajtja dhe transportimi

Mishi ruhet në kushte frigoriferike.

Në gjendje të ftohur ruhet në temperature nga 0 deri në -1 °C, me lagështirë relative 90-95 %, deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në +4 °C deri në 5 ditë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

- **Mish PULE**

Bazuar ne SSH 1168:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1168/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”.

Pamja e jashtme: Të ketë pamje të mirë me ngjyrë natyrore, muskulatura të jetë e zhvilluar mirë. Ngjyra e lekurës të jetë e bardhë me nuancë të verdhë.

Ambalazhimi: Të jetë me arka kartoni, me peshe deri në 16 kg. Mbi çdo arkë të jetë e vendosur etiketë e cila veç të dhënave të mësipërme të përmbajë: sasinë, datën e prodhimit e të skadencës dhe vulën e kontrollit të cilësisë.

Mishi të shoqerohet me fletë analizë.

Kofsha e pulës te jete e kontrolluar dhe e vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me **Raport Veterinar.**

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë. Raporti veterinar duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

- **SALLAM**

Bazuar ne SSH 1458:1990 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi:

- **Të jetë e cilësisë së parë.**

- **Lloji:**

viçi dhe derri.

Kërkesat

cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Forma:* E drejtë, cilindrike, e lidhur në dy fundet. Po të përdoren zorrë natyrore, sallami merr një formë harku.
- *Përmasat:*
 - o *Gjatësia, cm:* 40-50
 - o *Diametri, mm:* 40-50
- *Pamja e jashtme:* E plotë, e fortë, pa dëmtime sipërfaqësore, cipa të jetë e ngjitur mirë me brumin. Pa shenja myku ose jargë në sipërfaqe. Ngjyra e jashtme e kuqe-kafe e çelur, pa ngjyra ajri. Lejohet sipërfaqe myk i bardhë dhe i thatë, i cili s’ka depërtuar në brendësi. Fundet të jenë të lidhura mirë.
- *Qëndrueshmëria:* Elastike, nga shtypja e ushtruar të mos ngelet shenjë.
- *Era:* E këndshme, karakteristike për erërat e përdorura, pa erë të huaj.
- *Shija:* E këndshme, karakteristike për llojin e produktit me kripë normale ,

pa shije të huaj. Treguesit fiziko- kimik:

- *Lagështia, %, jo më shumë se 62.*
- *Nitrit mg/100g, jo më shumë se 20.*
- *Kripë, %, jo më shumë se 3.*
- *Yndyrë, %, jo më shumë se 12.*
- *Ngarkesa mikrobike:*
 - *Mikroflora e përgjithshme për gram/produkt:* 8000.
 - *Ecoli, për gram produkt:* Nuk lejohet.
 - *Stafilokokus aureus dhe proteus:* Nuk lejohet.
 - *Salmonella, për 25 g produkt:* Nuk lejohet.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. **Analiza mikrobiologjike (bazuar urdhri 645, datë 23.12.2016) Ambalazhimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Sallamet ambalazhohet në qese plastike me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadencës,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Sallamet për shitje shoqërohen me fletë analizë ku shënohen treguesit fiziko-kimikë, organo-shqisore dhe bakteriolgjikë. Reklamimi i produktit nga marrësit në dorëzim për defekte të dukshme shqisore bëhet në kohën e marrjes në dorëzim.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit fiziko-kimikë të mësipërm.

Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

Ruajtja dhe transportimi

Transportimi bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:**

	Produkti	Njesia	Sasia
1	Makarona	kg	815
2	Vaj	Liter	408
3	Oriz	kg	601
4	Gjalp gatimi	kg	122
5	Veze	Cope	6,145
6	Kripe	Pako	126
7	Qumesht	Liter	3,102
8	Patate	kg	476
9	Qepe	kg	152
10	Sheqer	kg	195
11	Çokokrem	kg	187
12	Miell	kg	544
13	Biskota	kg	187
14	Karrota	kg	111
15	Specë	kg	98
16	Vegete	Pako	72
17	Salce	Shishe	84

18	Mish Vici	kg	40
19	Fasule	kg	191
20	Sode Buke	Pako	24
21	Djath	Kg	211
22	Buding	Pako	532
23	Gjize	Kg	132
24	Salcice Vudi	Kg	71
25	Gjalp Bimor	Kg	111
26	Spinaq	Kg	21
27	Domate	Kg	30
28	Banane	Kg	65
29	Mandarina	Kg	100
30	Molle	Kg	106
31	Recel	Kg	71
32	Qepe te njoma	Kg	35
33	Kunguj Mishi	Kg	18
34	Lule Laker	Kg	18
35	Patellxhan I zi	Kg	18
36	Laker	Kg	25
37	Mish Pule	Kg	31

Afatet e lëvrimit: Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në një periudhë 1 vjeçare.

Lëvrimi do të jetë periodik, i përditshëm sipas kërkesave të institucioneve objekt furnizimi. Malli do të lëvrohet çdo ditë të javës nga e Hëna në të Premte.

Sasia e mallit që do të lëvrohet, do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor çdo ditë, në bazë të përloqaritjeve ditore, duke iu referuar frekuentimit ditor, menuesë ushqimore të çerdhes kopshtit , sipas normativave të miratuara.

Kushtet e lëvrim:

- Mallrat do të lëvrohen me automjetet e Subjektit Kontraktor në magazinën e Autoritetit Kontraktor.
- Furnizimi do të kryhet çdo ditë duke filluar prej orës 07:00 deri në orën 09:00.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 8, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit ”.

Ne hartimin e kriterëve për kualifikim, për objektin e prokurimit që përfshin furnizimin me produkte ushqimore, AK-ja ka përfshirë kërkesat e veçanta nga legjislacioni i fushës lidhur me disponimin e licensave dhe lejeve nga ana e operatorëve ekonomik ofertues.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjorë, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Produktet ushqimore duhet të jenë konform standarteve teknike të përcaktuara në ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”(I ndryshuar) si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit që prokurohet.
- b. Kopje e vertetuar te balanceve te tre viteve te fundit (2021, 2022 dhe 2023) te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet. ***ku te paktën në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit***”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

1.Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë:

a) Çertifikate qe garanton sigurine e ushqimeve ISO 22000:2018 (ose ekuivalente me te), te leshuar nga organet kompetente

2. Operatori ekonomik pjesemarres duhet te jete i pajisur me liçence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit me kategorite e meposhtme:

II.1.A.-Prodhim perpunim,shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.

3. Operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje “Magazine ushqimore”, e cila te sherbeje per ruajtjen e ushqimeve baze koloniale dhe fruta-perimeve ,te jete ne pronesi ose me kontrate noteriale per huaperdorje ose kontrate qeraje.Per kete OE duhet te paraqese:

a)Kontraten noteriale(huaperdorje ,ose te qerase)

b)Leje higjeno-sanitare/Akt miratimi higjeno-sanitar per ambjentin/objektin

4.OE duhet te disponoje Njesi tregtimi te ushqimeve me origjine shtazore e cila duhet te disponohet me nje kontrate bashkepunimi/furnizimi e vlefshme pergjate zbatimit te kontrates .

5.OE duhet te kete pjese te stafit teknik nje numer pre 2(dy) punonjesish per muajin e fundit(nentor 2024) , ku njeri duhet te jete patjeter shofer, i pajisur me leje drejtimi.

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit

6).Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor. Ne rastin e disponimit te mjetit me qera duhet te paraqse kontraten noteriale te qerase

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
